

VENDIM
Nr.358, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.500, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË AVOKATIT TË POPULLIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.500, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 1, lidhja nr.1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Në pikën 2, vlera “...9 306 (nëntë mijë e treqind e gjashtë) lekë...” zëvendësohet me vlerën “...10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë...”.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

KLASA	EMËRTIMI	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHITESA E POZICIONIT
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I-a	Sekretar i Përgjithshëm	10.050	2%	0	120 513
II-a	Ndihmëskomisioner kategoria e parë	10.050	2%	0	97 713
II-b	Ndihmëskomisioner kategoria e dytë Drejtor Drejtorie	10.050	2%	0	80 342
III-a	Përgjegjës sektori	10.050	2%	0	59 714
IV-b	Specialist	10.050	2%	0	21 714